



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:046608

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466653

**C.nr.761/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses – propozuesës A.B.1., nga fshati .... Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqësojnë A.A. dhe Z.S. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurit- kundërshtarit të sigurimit A.B.2., me banim në fshatin Lubizhdë Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të kontributit në martesë, vlera e kontestit 3,100.00 euro, duke vendosur sipas propozimit të paditëses - propozuesës të masës së përkohshme të sigurisë, me datën **18 Mars 2024**, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I. CAKTOHET MASA E PËRKOHSHME E SIGURIMIT, dhe i NDALOHET** të paditurit-kundërshtarit të sigurimit A.B.1., me banim në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, me qëndrim të përkohshëm në Zvicër, tjetërsimi dhe ngarkimi i paluajtshmërive në parcelat kadastrale P-71813046-..... ZK Lubuzhdë me sipërfaqe prej 967 m<sup>2</sup> me 1/1 e pjesës ideale si dhe ngastrën kadastrale me numër P-71813046-..... ZK Lubizhdë me sipërfaqe prej 708 m<sup>2</sup>, me 1/4 e pjesës ideale dhe zgjatë deri në përfundimin e kësaj çështje juridike, apo deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga gjykata.

**II. DETYROHEN** Zyra Kadastrale në Komunën e Prizrenit dhe Shërbimi Noterial në Prizren, ndalimin sipas paragrafit, nën I të dispozitivit, dhe ta evidentoj në regjistrat përkatës.

## **A r s y e t i m**

Paditësja A.B.1., këtu si propozuese nga fshati .... Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarve të sajë A.A. dhe Z.S. që të dy avokat nga Prizreni, pranë kësaj Gjykate, ka parashtruar padi kundër të paditurit - kundërshtarit të sigurimit A.B.2., me banim në fshatin .... Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të kontributit në martesë, vlera e kontestit 3,100.00 euro, me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit si në pikën I dispozitivit të këtij aktvendimi, duke theksuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e të njëjtës. Përmes propozimit për caktimin e masës së sigurisë të autorizuarit e paditëses nga ana e kësaj gjykate kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit, sikurse është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi. Ndër të tjera si kundër propozues e ka shënuar se në rastin konkret

ekziston rreziku i tjetërsimit të paluajtshmërisë nga ana e të paditurit, dhe qartë do të vështirësohet realizimi i të drejtës së palës paditëse. Më gjerësisht sikurse në këtë propozim.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e sigurimit si dhe pohimet e të autorizuarve të paditëses lidhur me caktimin e masës së sigurisë, si dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: ekstrakti i martesës i datës 28.12.2023, fletëtransferi i datës 07.02.2023 dhe kontrata e shitblerjes e noterizuar me numër LRP nr.1987/2023, Ref.519/2023 të dt. 15.02.2023, Gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse këtu propozueses të masës së përkohshme të sigurisë, për caktimin e masës së sigurimit **është i bazuar**.

Me nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decisive parashihet se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, sipas nenit 303 të LPK-së, është paraparë që *“ Gjykata mundet, duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, ti caktoj përnjëherë më tepër masa të sigurisë, kur ka nevojë për një gjë të tillë”*, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, *“propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjetet provuese t'ia bashkëngjisë propozimit”*.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të propozimit të paditëses, provave të lartpërmendura ka konstatuar se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit në këtë fazë të procedurës është i bazuar për këto arsye: paditësja këtu propozuesja A.B.1., dhe i padituri A.B.2., këtu kundërshtari i sigurimit kanë lidhur kurorë pranë Zyrës së Statusit Civil në Cyrih të Zvicrës më datë 08.03.2018, me nr.3.80/32129871/33834025. Paditësja më datë 07.02.2023, lidhur me shitblerjen e ngastrave kadastrale të lartcekura ja ka transferuar mjetet në shumë prej 15,000.00 CHF, këtu kundërshtarit të sigurimit duke ja besuar këtë punë dhe me besimin që ngastrat e lartcekura do t'i regjistroj edhe në emër të propozueses si pashkëshorte, për faktin se mjetet e shitblerjes ishin nga pasuria e tyre e përbashkët martesore, pasi që propozuesja për kontributin e saj të pasurisë së përbashkët martesore e njëjta ka punuar dhe është dëshmuar përmes konfirmimit të lëshuar nga Qendra shëndetësore për të moshuar në Langgrut të datave 17.11.2017 dhe 16.01.2024. Me kontratën e shitblerjes së paluajtshmërisë e noterizuar me numër LRP nr.1987/2023, Ref.519/2023 të dt. 15.02.2023, kundërshtari i sigurimit ka lidhë kontratë me të cilën kontratë ka blerë parcelat ngastrat e lartpërmendura, edhe përkundër faktit se këtu kundërshtari i sigurimit nga noteri është këshilluar që të deklarohet nëse mjetet materiale të çmimit të shitblerjes janë krijuar nga kontributi i të dy bashkëshortëve, i njëjti nuk ja ka paraqitur noterit certifikatën e martesës e lidhur pranë Zyrës së Statusit Civil në Cyrih të Zvicrës më datë 08.03.2018, me

nr.3.80/32129871/33834025, por i njëjti ja ka prezantuar vetëm certifikatën e lindjes duke u paraqitur si beqar e jo si i martuar duke i fshehur faktet se i njëjti është i martuar dhe mjetet e dedikuara për blerjen e ngastrave kadastrale janë mjete të fituara me punë të përbashkëta nga martesja e përbashkët. Andaj nga këto rrjedh se paditësja këtu si propozuese e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive dhe në këtë rast plotësohet njëri nga kushtet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të kërkuar në bazë të nenit 297. 1 pika a) të LPK-së.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, për momentin është i bazuar nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës nga palët, i paraparë me nenin 297.1 pika b), përkatësisht ka konstatuar ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala paditëse do të mund të pësoj ndonjë dëm të pariparueshëm. Andaj duke u nisur nga propozimi i palës paditëse me të cilin ka kërkuar që t'i ndalohet të paditurit shitblerja e paluajtshmërive kontestuese, e cila evidentohet në emër të paditurit, rrjedh fakti se nga ky propozim dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se vërtetë ka rrezik se pa caktimin e masës së këtillë, pala kundërshtarë do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me ndryshimin e gjendjes faktike, tjetërsimin e pronës, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses të masës së sigurimit, përkatësisht këtu paditëses.

Si përfundim, gjykata vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me nenin 297 parag.1 pikat nën a) dhe b) të LPK-së, për të caktuar masën e përkohshme të sigurimit, të propozuar nga palët paditëse.

Andaj nga të lartcekurat dhe konform nenit 306.1, lidhur me nenin 300.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr. 761/2024, datë 18 Mars 2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, kundërpropozuesi i masës së përkohshme të sigurimit – i padituri, ka të drejtën e deklarimit të kundërshtimit, brenda afatit 3 (tre) ditor i cili nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.